

Date: \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_\_

**NJOFTIMI PËR INFORMIM NGA KËRKUESI PRANË AGJENCISË KOMBËTARE TË MJEDISIT/AGJENCISË RAJONALE TË MJEDISIT DHE NJQV KU DO TË KETË VENDODHJEN INSTALIMI PËR APLIKIM PËR TU PAJISUR ME LEJE MJEDISI TË INSTALIMIT TË TIPIT A OSE B / NDRYSHIME NË FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT TË TIPIT A DHE B**

Bazuar në Ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, Ligjin Nr. 60/2014, datë 19.6.2014 Për një ndryshim në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar dhe VKM 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja”, Kreu VI “Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B”, pika 2, Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për “Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B” apo “Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”; Leje mjedisi tipi B
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së; AGROBLEND SH.P.K Nipi: J61918010D
3. Adresën e vendodhjes së instalimit; Muçaj, VORE, TIRANE
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim; ID 4, 7  
Magazhini i kimikateve përveçse kur parashikohet sipas endonje.....
5. Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e VNM-së në CD;
7. Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi; Nuk ka
8. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen; Agjencia Kombëtare e Mjedisit
9. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit;  
[info@akm.go.al](mailto:info@akm.go.al)

Mbaj përgjegjësi për dorëzimin e njoftimit pranë NJQV-së përkatëse në 20 CD/DVD

Kërkuesi/Përfaqësuesi i shoqërisë

(ADMINISTRATOR)

HANA ISMAILE

Nr.kontakti

0697487976



# PERMBLEDHJA JOTEKNIKE



**Subjekti:** Agroblend Shpk

**Nipti:** J61918010D

**Adresa kyesore:** Tirane Kavaje, Rruga Kombetare Kavaje-Rrogozhine,  
Km5,Godina 1 Kateshe Ne.2, 300 M para ures se Draçit,Zona Kadastrale Nr.3427,  
Nr pasurie 46/42, 46/48, 46/50 dhe 46/48.

**Vendodhje te aktivitetit:** Mucaj, Vore,Tirane.


## Permbledhja

1. Vendndodhja e aktivitetit
2. Pershkrimi I aktivitetit
3. Ndikimet e pritshme ne mjedis

### 1. Vendndodhja e aktivitetit

Subjekti zhvillues i ketij aktiviteti eshte subjekti **AGRO BLEND SH.P.K** i cili eshte i regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me Numer Identifikimi **NIPT: J61918010D** dhe me **vendndodhje te aktivitetit ne Mucaj, Tirane, Vore** dhe ka si Administratore **Znj. Hava Ismaili**.

Ky subjekt ushtron aktivitetin e tij per **magazinim plehrash kimike**. Sipas ekstraktit historik te QKB-se, data e regjistrimit te ketij subjekti eshte **02/02/1995**, me forme ligjore te tij si **Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar SH.P.K** dhe me status **Aktiv**.



### Vendndodhja e subjektit

**AGROBLEND** është vlerësuar nga shumë Fermerë dhe Bashkepunëtorë si nga te vetmit Partnerë të besueshëm për Progres në Bujqësi. Agrobblend kurrë nuk është kufizuar vetëm në tregëtimin dhe marketimin e produkteve të saj, por specialistët e saj janë shpeshherë në terren me qëllim që të asistojnë në zhvillimin e provave dhe produkteve të reja. E themeluar në 1993, si një firmë që operonte në sektorin e pesticidëve, Agrobblend tashmë është kthyer në Lider të Tregut Shqiptar për Inputet Bujqësore, duke tregtuar një gamë më të madhe Inputesh Bujqësore, si psh. Plehëra Kimike, Pesticide, Farëra, Fidanë Perimorë, Plastmas, Pompa spërkatëse, Sisteme vaditje dhe me pika, Polisterol, Torfë, Bikurina, etj.

Gjithashtu pranë Fermerit Agrobblend është vlerësuar nga shumë Fermerë dhe Partnerë si i vetmi Partner i besueshëm për Progres në Bujqësi. Ne kurrë nuk jemi kufizuar vetëm në tregëtimin dhe marketimin e produkteve tona, por specialistët tanë janë shpeshherë në terren me qëllim që të

asistojnë në zhvillimin e provave dhe produkteve të reja, duke ofruar gjithashtu mbështetje teknike për klientët tanë. Agroblend ka punuar dhe punon me sukses gjatë aktivitetit të saj me shumë Kompani Ndërkombëtare të ndryshme. Është gjithmonë e orientuar drejt standarteve përëndimore duke ndjekur dhe përdorur teknologjitë më moderne, duke krijuar një ambient të dëshiruar për biznes dhe staf profesional.

## 2. Pershkrimi I aktivitetit

### • Proceset e punes

Godina ku ushtrohet aktiviteti për magazinimin e kimikateve është godina 1-kateshe e ndare sipas disa ambjenteve :

Ambjenti në hyrje- ky ambient ka funksionin e reklamimit të produkteve (kimikateve). Në këtë ambient do të reklamohen për tu shitur të gjitha produktet që subjekti disponon të tilla si:

- Produkte/kimikate në shërbim të bujqësisë
- Produkte/plehra kimike/pesticide për kopshtet dhe ambientet e gjelberuara
- Kimikate për mbrojtjen e bimëve nga semundjet e ndryshme të shfaqura në to dhe për dezinfektim të ambjenteve të ndryshëm
- Fara lulesh dhe fara të tjera të ndryshme të përdorur nga fermeret, lule e plehra kimike

te llojeve të ndryshme.

**Një ambient tjetër**, i cili funksionon si magazine dhe shërben për magazinimin e kimikateve, produkteve të lengshme për mbrojtjen e bimëve dhe dezinfektimin e ambjenteve. Hapesira është e konsiderueshme për vendosjen dhe sisteminin e gjithë këtyre lendeve sipas ndarjeve të vecanta në varesi të llojeve të tyre dhe duke respektuar të gjitha kushtet ligjore e kërkuara për to.

Në një vend të caktuar, të ndodhur fare pranë të tjerave, të përmendura më sipër, magazinohen produktet/kimikatet duke u vendosur në ambalazhe me të mëdha dhe behen gati për tregtim të fermeret. Godina ku ushtrohet aktiviteti është e mbuluar me cati, ndërtuar me kapriata e konstruksione të tjera metalike.

Për sa i përket rrjetit rrugor që bën të mundur hyrjen në ambiente të brendshme të këtij subjekti, është ndërtuar një rrugë dhe një parkim për vendosjen e kamionave/makinave të klienteve dhe mjeteve të punës të furnizimit me produkte për subjektin. Është realizuar kjo strukturë ndërtimi pasi kështu bëhet e mundur levizja me lehtësi e kamionave dhe mauneve të punës, parkimi me lehtësi i tyre në këtë shesh duke bërë të mundur kështu një funksion sa më komod të këtij biznesi.

Ky subjekt ben magazinimin e kimikateve sipas kushteve themelore:

- Zoterimi i nje objekti te pergatitur posacerisht per magazinimin e kimikateve , subjekti ka ndertuar nje ndertese te pajisur me magazine per kryerjen e punes.
- Sigurimi qe brenda ketij objekti te mos hyjne persona te paautorizuar
- Realizimi i kushteve per mbrojtjen fizike dhe mbrojtjen nga zjarri, dhe sipas nevojës edhe kushteve te tjera parandaluese te rrezikut.

Kimikatet qe ky subjekt do te magazinoje duhet të mbahen dhe të ruhen mirë, në përputhje me llojin e rrezikut që mund të shkaktojnë. Në veçanti, duhet:

- të mbrohen kundër ndikimeve të rrezikshme nga jashtë
- të jenë të mbrojtura dhe të paarritshme për palët e paautorizuara
- të mbahen ose të ruhen në mënyrë të tillë që të parandalohet ndonjë rrezik, të mos shkaktohet konfuzion për ngjashmëri me mallrat e konsumit të përgjithshëm, veçanërisht me ushqime, ose për përdorimin gabimisht të tyre.

Gjate magazinimit te kimikateve mbahet parasysh qe:

- Kimikatet dhe paketimi i tyre duhet të mbrohen nga ndikimet e rrezikshme, veçanërisht nga ato të natyrës mekanike.
- Kimikatet duhet të jenë qartësisht të identifikueshme dhe gjatë ruajtjes në magazinë duhet të mbahen të ndara nga mallrat e tjera.
- Të mbahen vetëm në paketim origjinal, të mbyllur dhe të pathyeshëm ne thase ose ne fuci dhe konteniere.

Ky aktivitet, nuk ka ndikim ne mjedis, pasi produkti vjen i pergatitur dhe ambalazhuar nga jashte. Nuk ndikohet nga agjentet atmosferik. Ne kete ambjent kryhet vetem procesi i magazinimit dhe ai i tregtimit. Lendet e para te perdorura ne kete aktivitet jane kimikatet e importuara nga jashte te amabalazhuara sipas standartit dhe me logot perkatese, sipas funksionit qe kane.

### Foto nga subjekti



### 3. Ndikimet e pritshme ne mjedis nga zhvillimi I aktivitetit

Ndikimet e mundshme gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permblihen sipas elementeve te mjedisit, si me poshte:

<b>Ndikimet ne toke</b>	
<b>Burimi I ndikimeve</b>	<b>Pasojat ne Mjedis</b>
Nga magazinimi I kimikateve	Ne rast derdhje aksidentale duhen marre masa te menjehershme per pastrimin e vendit
Nga trasporti i tyre	Gjate transportit kimikatet duhet te ruhen te mos kete derdhje ose rrjedhje te tyre
<b>Ndikime ne uje</b>	
Nyjet sanitare	Nga nyjet sanitare mund te kete shkarkime normale nga vete natyra e ketij aktiviteti Perdorimi I ujit te bollshme qe te ket nje ndikim me te paket
<b>Ndikime ne biodiversitet</b>	
Objekti ne teresi	Ky subjekt ka nje aktivitet ekzistues por ne ambientet e brendshme dhe per kete arsye nuk do te kete ndikime ne ambientet e jashtme te aktivitetit .

	Ne brendesi te subjektit ku zhvillohet aktiviteti cdo gje jane te sistemuara dhe rregulluara ne detaje.
Makinerit e transportit ne ambjentin e jashtem	Numri I makinerive nuk eshte shum I larte megjithese kane nje kujdes ne ecjen e makinerive ne nje shpejtesi te normale duke ruajtur edhe mosperhapjen e pluhrave ne mjedis Gjithashtu ne mjedisin e jashtem behet nje sprucim me uje ne menyre qe te mos kemi perhapjen e pluhrave ne mjedis
<b>Ndikimi ne ajer</b>	
Magazina e kimikateve	Si pasoje e levizjes se automjeteve do te gjenerohen : <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhurma nga levizja e makinerive</li> <li>• Pluhrat e mundshme qe vij perseri si pasoje e makinerive</li> <li>• Gaze nga djegia e karburantit mund te kene nje gjenerim me te larte sepse pervec punes se aktivitetit vine dhe mjete te tjera per furnizim.</li> </ul>

<b>Ndikimet ne toke</b>	
<b>Burimi I ndikimeve</b>	<b>Masat e marra per rehabilitim e tyre</b>
Nga magazinimi I kimikateve	Pastrimi I vendit ne menyre te menjehershme me uje te bollshem  Vendosja e tabelave per kujdesin ndaj kimikateve dhe derdhjen e tyre ne toke

Nga trasporti i tyre	Kapja me mjete te forta per mos derdhjen e tyre si dhe sigurmi I mire ne makinerit e transportit
<b>Ndikime ne uje</b>	
Nyjet sanitare	Perdorimi I ujit te bollshme qe te ket nje ndikim me te paket.
<b>Ndikime ne biodiversitet</b>	
Objekti ne teresi	Rregullsia e dhe stabiliteti i aktiviteti ne menyre te tille qe mos te kete asnje ndikim edhe pse nga natyra e aktivitetit nuk ka ndikime ne biodiversitet.
Makinerit e transportit ne ambjentin e jashtem	Kujdesi I uljes se shpejtesise se mjeteve te transportit  Gjithashtu ne mjedisin e jashtem duhet behet nje sprucim me uje ne menyre qe te mos kemi perhapjen e pluhrave ne mjedis
<b>Ndikimi ne ajer</b>	
Magazina e kimikateve	Lagia e ambjentit ne menyre te her pas hershme qe most e kete ndikime ne ajer nga aktiviteti I makinerive

**AGRO BLEND SH.P.K**

**Administratori**

**Hava Ismaili**

